



BiEPAG

Tetor 2023

Dilema energjetike e Serbisë: HULUMTIMI I TENSIONEVE GJEOPOLITIKE, PRONËSIA RUSE DHE RRUGA DREJT TRANZICIONIT TË RINOVUESHME

Autor: Vujo Ilić*

** Info për projektin kërkimor*

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (BiEPAG) po realizon një studim gjithëpërfshirës për gjeopolitikën e tranzicionit drejt energjisë së gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Ky dokument politikash mbështetjet në gjetjet e dokumentit të parë "Energjia në Ballkanin Perëndimor" (maj 2023) dhe në një sondazh të realizuar në nivel rajoni në Ballkanin Perëndimor, puna në terren e të cilit u krye në gjatë muajve mars-prill 2023. Gjetjet kryesore të këtij studimi bazohen në të dhënat e mbledhura nëpërmjet punës kërkimore dhe intervistave gjysmë të strukturuar të realizuara në muajt mars-qershor 2023 me nëntë vetë, punonjës aktualë dhe të mëparshëm të qeverisë politikanë të opozitës aktuale, ekspertë ndërkombëtarë të sigurisë dhe energjisë, një ish drejtor ekzekutiv i një kompanie të prodhimit të energjisë si dhe një përfaqësues të Komunitetit të Energjisë. Ky dokument u hartua me kontributin e anëtarëve të BiEPAG, Tena Prelec, Dimitar Bechev dhe Nikolaos Tzifakis. Vujo Ilić është studiues në Institutin për Filozofi dhe Teori Sociale të Universitetit të Beogradit.

Rekomandime për politikën

E duhet të vazhdojë të ofrojë stimuj për dekarbonizimin në Serbi, kryesisht duke reduktuar përdorimin e qymyrit, nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare, krijimit në kohë të një skeme rajonale të tregtimit të emetimeve dhe një fondi të përshtatshëm tranzicioni.

BE dhe vendet e saj anëtare duhet të mbështesin investimet në projekte energjetike që janë miqësore me mjedisin dhe për ndërgjegjësimin dhe angazhimin e publikut në tranzicionin energjetik për të ndihmuar në forcimin e perceptimeve pozitive politike për BE-në.

BE duhet të vazhdojë t'i mundësojë Serbisë të arrijë sigurinë e gazit natyror dhe diversifikimin e furnizimit duke rritur numrin dhe kapacitetin e ndërlihdësve, duke zgjeruar kapacitetet të depozitimit nëntokësor të gazit dhe përmes skemave të përbashkëta të blerjes së gazit, me qëllim përdorimin e gazit gjatë fazës së eliminimit të qymyrit dhe kalimit drejt burimeve të rinovueshme.

Abstrakt

Ky dokument politikash merr në shqyrtim rrjetin kompleks të sfidave që mundojnë sektorin energjetik të Serbisë, duke analizuar kombinimin e ngjarjeve gjatë dimrit 2021-2022 që shkaktuan krizën aktuale. Një avari në termocentralin Nikola Tesla, i përkeqësuar nga mungesa e investimeve dhe keqmenaxhimi, ndodhi pikërisht gjatë krizës globale të energjisë. Pushtimi rus i Ukrainës i rriti më tej shqetësimet, duke nxjerrë në pah dobësitë e furnizimit me energji të Serbisë, e cila ka varësi të madhe nga subjektet me pronësi ruse. Këto ngjarje e detyruan Serbinë të bëjë shpenzime të paprecedenta për të siguruar furnizime me energji dhe rinxorën në sipërfaqe pyetje rreth orientimit të saj strategjik dhe tranzicionit energjetik. Ky studim shqyrton me imtësi rolin e pronësisë ruse në peizazhin energjetik të Serbisë, duke u fokusuar kryesisht në Kompaninë e Karburanteve NIS, dhe e shtrin analizën në dinamikën dhe gjeopolitikën e gjerë të tranzicionit energjetik. Studimi hedh dritë mbi kontekstin historik të investimeve ruse në naftë dhe gaz, ndikimin e saj në sigurinë energjetike të Serbisë dhe në ndërveprimin kompleks mes interesave ruse, kineze dhe perëndimore, politikës lokale dhe konsideratave mjedisore. Teksa Serbia përballet me një krizë të shumanshme energjetike, identifikohen rrugët e mundshme drejt së ardhmes, duke theksuar nevojën për diversifikim e furnizimit me gaz, duke lehtësuar kalimin drejt burimeve të rinovueshme dhe duke analizuar ndërlikimet gjeopolitike që ndërthuren me shqetësimet mjedisore. Studimi nënvizon rolin kryesor të BE-së dhe aktorëve të huaj në formësimin e së ardhmes energjetike të Serbisë dhe ofron rekomandime për përafrimin e strategjive kombëtare me objektivat evropiane të tranzicionit energjetik.

Konteksti i vendit: Sektori i energjisë së Serbisë në krizë

Gjatë dimrit 2021-2022, sektori i energjisë në Serbi u godit nga një stuhi e paparë. Ndërkohë që kriza globale energjetike po arrinte kulmin e saj në dhjetor 2021, një bllok i madh i termocentralit Nikola Tesla afër Beogradit u prish për shkak të cilësisë së dobët të qymyrit të linjitet që po përdorej (një burim primar energjetik për vendin) dhe për shkak të viteve të mungesës së investimeve dhe keqmenaxhimit të shoqërisë publike të energjisë elektrike EPS.¹ Përballë mungesës së mundshme të energjisë elektrike gjatë dimrit, periudhë në të cilën kërkesa për energji zakonisht arrin kulmin, Serbisë iu desh të shpenzonte shuma të mëdha parash për të blerë energji elektrike dhe qymyr.²

Pushtimi rus i Ukrainës në vitin 2022 ishte një tjetër ngjarje që rrezikoi nga themelet të gjithë strukturën e furnizimit me energji në Serbi. Përveç shkaktimit të një krize gazi në Evropë, varësia e plotë e Serbisë nga gazi rus i bëri operacionet e kompanive ruse në vend një çështje emergjente. Në Serbi, gazi merret dhe ruhet përmes kompanive në pronësi ruse, ndërsa kompania e karburanteve NIS, shumica e aksioneve të së cilës janë në pronësi të Gazprom Neft, është i vetmi prodhues i naftës bruto dhe gazit natyror, i vetmi përpunues i naftës dhe pronar i rrjetit më të madh të pikave të shitjes me pakicë të karburantit. Teksa BE negocionte sanksione të reja kundër kompanive në pronësi shumicë ruse dhe i bëri thirrje Serbisë që të bashkohej me to, Serbia zgjodhi të dënojë zyrtarisht sulmin ndaj Ukrainës, por të ruajë marrëdhëniet e saj të mira me Rusinë dhe të shmangë bashkimin me çdo sanksion kundër individëve apo subjekteve në pronësi ruse.³

Serbia përfundimisht u përjashtua nga Rregullorja e Këshillit (BE) 2022/428 e datës 15 mars 2022, rregullore që do të ndalonte angazhimin me kompanitë me më shumë se 50% të pronësisë nga Gazprom Neft, i cili në atë kohë zotëronte

1 Igor Todorović, 'Probleme të reja për EPS-në e Serbisë: uzina e qymyrit TENT B është jashtë pune pas avarive nga zjarri, Balkan Green Energy News, 28 dhjetor 2021, <https://balkangreenenergynews.com/new-troubles-for-serbias-eps-coal-plant-tent-b-is-offline-amid-breakdown-fire/>.

2 Ivana Sekularac, Aleksandar Vasovic, 'Serbia bën gati 3 miliardë euro për import të energjisë në dimër, Reuters, 15 shtator, 2022, <https://www.reuters.com/business/energy/serbia-readies-3-bl-euros-energy-imports-winter-2022-09-15/>.

3 Milica Stojanovic, 'Serbia mbështet rezolutën e OKB-së që dënon sulmin rus ndaj Ukrainës, Balkan Insight, March 2, 2022, <https://balkaninsight.com/2022/03/02/serbia-backs-un-resolutioncondemning-russian-attack-on-ukraine/>.

56% të NIS serb.⁴ Në maj 2022, pronësia ruse e NIS u siguroa, të paktën për momentin, kur Gazprom, kompania mëmë e Gazprom Neft, e cila nuk ishte përfshirë në paketën e sanksioneve, bleu 6% të aksioneve dhe uli kësaj përqindjen e aksioneve të filialit të saj të sanksionuar Gazprom Neft në 50% për të parandaluar sanksionimin në fazat e mëvonshme të NIS.⁵ Menjëherë pas kësaj, presidentët Vuçiç dhe Putin ranë dakord për një marrëveshje të re tre-vjeçare të furnizimit me gaz pas skadimit të kontratës dhjetëvjeçare dhe zgjatjes me gjashtë muaj të kësaj kontrate me Serbinë.⁶

Ngjarjet e viteve 2021-2022 janë tregues i gjendjes së pasigurt në sektorin energjetik serb, i cili po përballet me një krizë të shumanshme. Sektori i energjisë, veçanërisht prodhimi i energjisë elektrike, është shumë i varur nga lëndët djegëse fosile, i paefektshëm dhe i mbushur me interesa të ngushta. Ndryshe nga pritshmëritë në rritje nga BE-ja për kalimin e saj në energjinë e gjelbër, ritmi i tranzicionit energjetik të Serbisë është i ngadaltë dhe ndonëse autoritetet shpesh kanë shpallur plane të mëdha, ata kanë një histori për të ardhur keq kur vjen puna te zbatimi i tyre.⁷

Ndikimi i huaj në sektorët e energjisë dhe minierave mund të jetë një forcë e jashtme me rëndësi të madhe që ruan status quo-në aktuale të tranzicionit energjetik. Rusia është e pranishme kudo në sektorët e naftës dhe gazit në Serbi dhe ka interes të ruajë pozicionin e saj si furnitori kryesor i Serbisë me gaz.⁸ Vitet e fundit, Kina është bërë një investitor kryesor në Serbi, kryesisht në industrinë e automobilave dhe minierave, pavarësisht shqetësimeve në rritje për mjedisin te publiku i gjerë serb.⁹ Megjithatë, Kina po bën depërtime edhe në sektorin e energjisë. Huat dhe ndërtimet kineze kanë qenë vendimtare për përfundimin e termocentralit me qymyr dhe gaz. Ka edhe plane për të ndërtuar një central diellor.¹⁰

Ky studim synon të shqyrtojë këtë lidhje mes aktorëve të huaj dhe tranzicionit energjetik në Serbi, duke u fokusuar në rolin e pronësisë ruse të NIS, por duke e shtrirë analizën edhe në kontekstin më të gjerë të gjeopolitikës dhe tranzicionit energjetik në Serbi.

4 Këshilli i Bashkimit Evropian, Rregullorja e Këshillit (BE) 2022/428, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian L 87 I/13, 15 mars 2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022R0428>.

5 Interfax, 'Gazprom Neft ul aksionet në NISH të Serbisë në 50%', Gazprom merr 6.15%', 11 maj 2022, <https://interfax.com/newsroom/top-stories/79039/>

6 Vladimir Spasić, 'Putin e Vuçiç ranë dakord për kontratën e re të furnizimit me gaz për Serbinë', Balkan Green Energy News, 30 maj 2022, <https://balkangreenenergynews.com/putin-vucic-agree-on-newgas-supply-contract-for-serbia/>.

7 Komuniteti i Energjisë, 'Raporti Vjetor i Zbatimit për Serbinë', Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, 1 nëntor 2022, https://www.energy-community.org/dam/jcr:a2ee5af3-ab4d-4573-9e08-7702ffd810c8/IR2022_Serbia.pdf.

8 Ben Reade, 'Jo më z. Burrë i Mirë: Hetimi i kapitalit gjërryes në industrinë serbe të energjisë', Buletini i Shoqërisë Gjeografike Serbe 103(1): 355-386, 2023, <https://doiserbia.nb.rs/img/doi/0350-3593/2023/0350-35932301355B.pdf>.

9 Stefan Vladislavljev, 'Arritja e niveleve të reja të marrëdhënieve kino-serbe', Vëzhgues të Kinës në Evropën Qendrore dhe Lindore, 3 janar 2023, <https://chinaobservers.eu/reaching-the-new-levels-of-sino-serbian-relations/>.


10 Stefan Vladislavljev, 'Si u bë Kina investitori më i madh në Serbi?', Vëzhgues të Kinës në Evropën Qendrore dhe Lindore, 8 gusht 2023, <https://chinaobservers.eu/how-did-china-become-the-largest-investor-in-serbia/>.

Investimet ruse në naftë dhe gaz

Investimet ruse në naftë dhe gaz në Serbi ishin të lidhura së bashku që në fillim dhe nuk mund të analizohen veçmas. Ato rrjedhin nga marrëveshja ndërkombëtare e nënshkruar në Moskë më 25 janar 2008, vetëm disa javë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Elementët kryesorë të marrëveshjes përfshinin ndërtimin e Gazsjellësit Rrjedha e Jugut dhe depozitimin nëntokësor të gazit në Banatski Dvor, si dhe blerjen e 51% të Kompanisë së Naftës NIS nga Gazprom Neft, e cila përfshinte rrjetin e shpërndarjes, dy rafineri të naftës dhe fusha naftëmbajtëse në Serbi dhe jashtë saj.¹¹

Blerja e NIS u konsiderua problematike nga publiku serb. Në një sondazh të BiEPAG të kryer në vitin 2023, vetëm një e treta e të anketuarve (34%) ranë dakord që investimi i Gazprom Neft ishte transparent dhe i kryer sipas rregullave (Figura 1).¹² Pjesa më e madhe e aksioneve në NIS u shit për rreth 400 milionë euro, për të cilën shumë argumentuan se ishte më pak se vlera e vërtetë. Kësaj perspektive iu dha më shumë legjitimitet në gusht të vitit 2014 kur Ministria e Punëve të Brendshme serbe njoftoi se kishte krijuar një ekip të posaçëm hetimor për të shqyrtuar privatizimin e NIS nën qeverinë e mëparshme, megjithëse hetimi dështoi pas disa vitesh pa ndonjë rezultat të qartë.¹³

Figura 1. Qëndrimet ndaj investimeve të Gazprom Neft në NIS. Burimi: sondazhi i BiEPAG, N = 1,019 [2023]



11 Nikolić Kokanović Otašević Law Office, 'Analiza Ligjore e Marrëveshjeve ndërmjet Serbisë dhe Ruisë në Sektorin e Naftës dhe Gazit', Qendra e Çështjeve Ndërkombëtare dhe të Sigurisë (ISAC), 21 dhjetor 2009, <https://www.isac-fund.org/download/Summary%20and%20Conclusions.pdf>.

12 Dimitar Bechev, Tena Prelec, Nikolaos Tzifakis, Florian Bieber, Marko Kmezic, Milica Delevic, Marika Djolai, Donika Emimi, Vujo Ilic, Zoran Nechev, Milena Stefanovic, Corina Stratulat, 'Gjeopolitika e Tranzicionit të Energjisë së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor', 24 maj 2023, Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (BiEPAG).

13 Ivana Sekularac, 'Policia serbe do të hetojë privatizimin e firmës shtetërore të naftës NISH, Reuters, 12 gusht 2014, <https://www.reuters.com/article/uk-serbia-nis-investigation/serbian-police-toprobe-privatisation-of-state-oil-firm-nis-idUKKBN0GC0L420140812>.

Përkrahësit e "marrëveshjes së naftës dhe gazit" të vitit 2008 me Rusinë e mbrojtën atë për shkak të investimeve të pritshme të Gazprom Neft në modernizimin e NIS dhe fitimeve që parashikoheshin se do të kishte Serbia në të ardhmen nga transportimi i gazit përmes Gazsjellësit Rrjedha e Jugut. Megjithatë, në vitin 2009, BE miratoi një paketë të tretë të energjisë ku kërkohet që transmetimi dhe prodhimi/furnizimi i gazit të ndahen nga ana strukturore.¹⁴ Kjo përfundimisht çoi në tërheqjen e Rusisë nga projekti i Gazsjellësit Rrjedha e Jugut në 2014 në favor të Gazsjellësit TurkStream, që u vu në punë vetëm në vitin 2021.¹⁵

Që nga blerja e saj nga Gazprom Neft, NIS ka pasur një pozicion dominues në tregun e naftës. Edhe pse importi i lëndëve djegëse motorike është liberalizuar në Serbi, NIS ka qenë i vetmi prodhues vendas i nënprodukteve të naftës dhe në vitin 2022, kompania kishte 83% të tregut me shumicë në karburantet motorike, sipas raportit të saj vjetor.¹⁶ Siç tregohet në Figurën 2, Grupi NIS zotëron edhe rrjetin më të madh të shpërndarjes në Serbi, ku kjo kompani zotëron 22% të pikave të karburantit në vend (322 në total, duke përfshirë NIS Petrol dhe markën e saj premium Gazprom).¹⁷ Edhe rrjeti i dytë më i madh i pikave të shitjes së karburanteve, Lukoil, është në pronësi ruse. Ky rrjet zotëron 7.5% të pikave të karburanteve. Pesë distributorët e mbetur ndërkombëtarë ose rajonalë me rrjete në Serbi (OMV, EKO, MOL, AVIA dhe Petrol) operojnë 212 ose 14% të të gjitha stacioneve të karburanteve. Megjithatë, në krahasim me shitësit e tjerë, veçanërisht më të vegjël, NIS ka një rrjet të mirëpozicionuar të stacioneve të karburanteve me xhiro të madhe, duke e çuar pjesën e tij në tregun me pakicë në 50%, edhe pse pjesa e tij në numrin total të stacioneve të karburanteve është sa gjysma e asaj.¹⁸

14 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 211, 14 gusht 2009, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=OJ:L:2009:211:TOC>. Zyra ligjore Samardžić, 'Serbia miraton rregulla që parandalojnë gazsjellësin e Rrjedhës së Jugut?', Revista ligjore, 17 korrik, 2015, www.specht-partner.com/wp-content/uploads/2015/07/150717-Legal-Insight-Serbiaadopts-3rd-Energy-Package-preventing-South-Stream.pdf.


15 Darya Korsunskaya, 'Putin heq tubacionin e gazit Rrjedha e Jugut për në BE, favorizon Turqinë', Reuters, 1 dhjetor 2014, <https://www.reuters.com/article/us-russia-gas-gazprom-pipelineidUSKCN0JF30A20141201>.

16 Grupi NISH, 'Raporti vjetor për 2022', 2023, https://ir.nis.rs/wp-content/uploads/2023/04/AR_2022_eng.pdf.

17 Ministria e Tregtisë së Brendshme dhe të Jashtme, "Baza e të dhënave publike të pompave të benzinës në Serbi", 2 tetor 2023, <https://must.gov.rs/tekst/sr/384/javna-baza-benziskih-stanica-u-srbiji.php>.

18 Grupi NISH, 'Raporti vjetor për 2022',

Figura 2. Harta e pikave të karburantit në Serbi. Burimi: Ministria e Tregtisë së Brendshme dhe të Jashtme [2023]



Përveç kësaj, NIS që nga blerja e tij ka investuar në modernizimin e prodhimit të benzines në vend. Në një intervistë, një ish drejtues i kompanisë shpjegoi se para privatizimit, tregu ishte relativisht i parregulluar në lidhje me cilësinë e nënprodukteve dhe ekonominë gri, por se NIS “ka ndikuar, në një kuptim pozitiv, që shteti të rregullojë tregun”. Po kështu, rafineria që bleu Gazprom Neft nuk përmbushte standardet e BE-së, por pas investimeve, “rafineria prodhon lëndë djegëse të së njëjtës cilësi si në Francë apo Gjermani”. Ky shpjegim është në përputhje me gjetjet e sondazhit BiEPAG, në të cilin 50% e qytetarëve serbë besonin se investimi i Gazprom Neft në NIS e ndihmoi Serbinë të rriste sigurinë e saj energjetike.

Në ndryshim nga nafta dhe nënproduktet e saj, përfshirja ruse në gaz në Serbi ka ndjekur një rrugë tjetër. Pavarësisht se kompania kombëtare e gazit Srbijagas mbetet në pronësi publike me shumicë të aksioneve në pronësi serbe, Gazprom ka ushtruar ndikim shumë më të madh në këtë sektor krahasuar me sektorin e naftës. Ndonëse Gazsjellësi Rrjedha e Jugut nuk u realizua kurrë, Gazprom ka mbetur furnitori i vetëm i gazit në Serbi, duke kontrolluar drejtpërdrejt rezervat serbe të gazit dhe madje edhe pjesë të tubacioneve në Serbinë Jugore përmes një kompanie në pronësi të përbashkët, Yugorosgaz.¹⁹

Për më tepër, ndryshe nga nafta, Gazprom ka ruajtur monopolin e tij në tregun me shumicë dhe dominon qartësisht në tregun me pakicë. Varësia e Serbisë nga gazi rus në fakt ka mbetur e paprekur që nga viti 2008, pavarësisht sfidave të shumta. Ndikimi i Gazprom mbi kompaninë vendase të gazit të Serbisë është ushtruar përmes emërimeve politike në bordet drejtuese të kompanive vartëse. Dushan Bajatoviç, një anëtar i rangut të lartë i Partisë Socialiste të Serbisë, e cila është një partner i vogël koalicioni i Partisë Progresive Serbe në pushtet, u njoh nga bashkëbiseduesit e shumtë të këtij studimi si ndërmjetësi i pushtetit për aktorët vendas dhe të huaj me interes për ruajtjen e status quo-së.


¹⁹ Komuniteti i Energjisë, ‘Raporti Vjetor i Zbatimit 2015/2016’, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, 1 shtator 2016, https://www.energy-community.org/dam/jcr:d486761d-7d19-4ac6-b55f-2cf838f689bd/EnC_IR2016.pdf.

Nafta kundër gazit – rruga drejt varësisë

Diskutimi i mësipërm ngre pyetjen se përse Serbia krijoi që në fillim varësi nga gazi rus. Prania e Rusisë në sektorët e gazit dhe naftës erdhi nga të njëjtat marrëveshje ndërshtetërore, por secili rast u zhvillua ndryshe. Aktorët me të cilët folëm e perceptuan NIS pas blerjes nga Gazprom Neft të fokusuar kryesisht tek fitimet dhe më pak tek gjeopolitika. Kjo kompani u konsiderua si një entitet plotësisht i korporatizuar që mund të veprojë si “partner” për qeverinë. Nga ana tjetër, kompania mëmë, Gazprom, drejtpërdrejt dhe përmes Srbijagas, ruan një “monopol të rezervuar” në sektorin e gazit që është politikisht jashtë kontrollit të autoriteteve. Siç e përshkroi edhe një ish zyrtar i qeverisë bashkëpunimin me NIS si “normal” dhe “profesional”, Srbijagas konsiderohej si e paprekshme dhe e pakontrollueshme: “Nuk mund të merrnim një dokument të vlefshëm nga ajo kompani, dhe kur na dërgohej diçka, e verifikonim atë pesë herë dhe nuk mund të ishim të sigurt nëse ishte i saktë.”

Ndryshimi në mënyrën se si kanë vepruar kompanitë publike në pronësi të huaj dhe vendase mund të shpjegohet më së miri në lidhje me varësinë relative të Serbisë nga nafta dhe gazi. Gjatë viteve të fundit, nafta ka mbërritur në Serbi nga tregu global, kryesisht nga Iraku, përmes tubacioneve JANAF, dhe nuk ka pasur kurrë varësi nga nafta ruse (Figura 3).²⁰ Edhe pse Rusia është pronare e kompanisë, NIS po reduktonte në mënyrë të qëndrueshme importet e naftës ruse përpara pushtimit të Ukrainës në vitin 2022. Nëse marrëdhëniet politike me Rusinë do të prisheshin, nafta mund të vazhdonte të rridhte drejt Serbisë.

Figura 3. Nafta e importuar e papërpunuar sipas shtetit (lloji).
Burimi: Agjencia e Energjisë e Republikës së Serbisë [2021]



20 Agjencia e Energjisë e Republikës së Serbisë, 'Raporti Vjetor i Agjencisë së Energjisë 2021, 2022, <https://www.aers.rs/Files/lzvestaji/Godishnji/lzvestaj%20Agencije%202021.pdf>.

Situata me gazin nuk mund të ishte ndryshe. Deri në vitin 2021, kur Gazsjellësi Rrjedha e Ballkanit (Balkan Stream) – një zgjatim i tubacionit TurkStream që sjell gaz përmes Bullgarisë – u hap në vend të Gazsjellësit të braktisur Rrjedha e Jugut, Serbia importonte të gjithë gazin e saj nga Rusia përmes një rruge të vetme që kalonte nga Hungaria. Edhe pse kjo rrugë e re tani është e hapur, Serbia ende mund të blejë gaz vetëm nga Rusia derisa të përfundojë linja e re ndërlidhëse me Bullgarinë.

Disa bashkëbisedues me të cilët folëm theksuan se diversifikimi i furnitorëve të gazit nuk ka ndodhur kurrë pavarësisht disa goditjeve, përfshirë këtu krizën e gazit të vitit 2004, rritjen e çmimeve në vitin 2009 dhe rënien e furnizimit në vitin 2014. Ka disa arsye për këtë, siç janë përfitimet politike, marrëveshjet e biznesit vendas dhe taktikat ruse të përdorimit të forcës. Në vitet 2000, vendimmarrësit në Serbi e shihnin ofrimin e gazit të lirë për konsumatorët si një mundësi për të siguruar mbështetje politike dhe si një formë për të tërhequr investitorët e huaj në Serbi. Edhe në vitin 2022, Agjencia Serbe e Energjisë ende promovonte gazin për konsumatorët si karburantin më të lirë për ngrohje.²¹ Gazifikimi i brendshëm i qyteteve serbe kishte gjithashtu një potencial të rëndësishëm për patronazh dhe korrupsion, duke qenë se karakterizohej thellësisht nga mungesa e transparencës. Një ekspert i energjisë së rinovueshme na tha se gazifikimi i brendshëm shpesh ndodhte pa marrë parasysh nevojat lokale dhe kërkesat për energji.

Në vitet 2010, Rusia pengoi diversifikimin e furnizimit me gaz dhe e pengoi Serbinë të rriste kapacitetet për depozitim nëntokësor të gazit. Pavarësisht planeve që u njoftuan për të dyfishuar kapacitetin e depozitimit nëntokësor të gazit në Serbi, këto projekte nuk u materializuan kurrë dhe Serbia u detyrua të mernte me qira depo gazi nga Hungaria fqinje me një çmim shumë më të lartë. Një ish zyrtar i qeverisë na tha se kjo ishte për shkak se rusët “nuk mund të pajtoheshin në thelb me Serbinë” për këtë çështje.

Në vitin 2014, Gazprom reduktoi furnizimin me gaz në Serbi, duke përmendur borxhet e pazgjdhura që nga vitet 1990, një çështje marginale e nxjerrë në dritë vetëm disa javë pas një vizite të Vladimir Putin në Beograd,²² të cilën shumë e panë si një mesazh politik se marrëveshjet e dobishme me Rusinë ishin në rrezik.²³ Në një nga intervistat tona, një ekspert ndërkombëtar i sigurisë e quajti këtë “një shembull klasik të përdorimit si armë” dhe theksoi se para vitit 2022, Serbia ishte vendi i dytë në Evropë, pas Ukrainës, që kishte përjetuar përdorimin e drejtpërdrejtë të gazit në këtë mënyrë si një instrument për ushtrimin e presionit politik.

21 Agjencia e Energjisë e Republikës së Serbisë, ‘Troškovi energije za grejanje stambenog prostora, grejna sezona 2022/2023’ [Kostot e energjisë për ngrohjen e ambienteve të banimit, sezoni i ngrohjes 2022/2023], 20 tetor 2022, <https://www.aers.rs/Index.asp?!=1&a=541&id=317>

22 Julian Borger, ‘Vladimir Putin lëviz për të forcuar lidhjet me Serbinë në paradën ushtarake’, Guardian, 16 tetor 2014, <https://www.theguardian.com/world/2014/oct/16/vladimir-putinrussia-serbia-alliance-military-parade>.

23 The Moscow Times, ‘Serbia lufton për të paguar borxhin rus për gazin’, 3 nëntor 2014, <https://www.themoscowtimes.com/2014/11/03/serbia-struggles-to-pay-russian-gas-debt-a40988>.

Vetëm pushtimi rus i Ukrainës në vitin 2022 mund të ketë kthyer ekuilibrin drejt diversifikimit. Një zyrtar aktual i qeverisë na tha: “Ne si vend e kemi marrë seriozisht problemin e varësisë nga një burim energjie dhe nga një furnitor i vetëm”. Interkonektori me Bullgarinë, i cili më në fund do t’i bënte të mundur Serbisë të diversifikonte furnizimin me gaz, tani duket se është i realizueshëm. Ndonëse planet kanë qenë në zbatim që nga viti 2015, ndërtimi i interkonektorit filloi vetëm në shkurt 2023, me një datë të pritshme përfundimi në fund të vitit.²⁴ Kjo do t’i lejonte Serbisë të merrte gaz nga Azerbajxhani²⁵ dhe gazin natyror të lëngshëm me gjasa nga Greqia.²⁶

Investimet ruse dhe tranzicioni i energjisë

Përqindja e energjisë së rinovueshme në përzierjen energjetike të Serbisë është rritur ngadalë vitet e fundit. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme vjen nga hidrocentralet, që në vitin 2021 përbënte 30% të të gjithë energjisë elektrike të prodhuar, kryesisht nga centralet e mëdha të periudhës jugosllave. Hidrocentralet e vogla janë zgjeruar kohët e fundit për shkak të tarifave preferenciale nxitëse që favorizojnë kompanitë me lidhje politike. Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, hidrocentralet e vegjël kanë marrë 70% të tarifave nxitëse për energjinë e rinovueshme.²⁷ Megjithatë, në vitin 2021 hidrocentralet e vogla në Serbi prodhuan vetëm 0.85% të gjithë energjisë elektrike.²⁸ Këto termocentrale kanë krijuar shumë më tepër polemika për shkak të ndikimit të tyre negativ në mjedis dhe dëmtimit që kanë shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore si dhe për shkak të efektit të tyre në komunitetet lokale, në turizëm, dhe bujqësi.²⁹

24 Qeveria e Serbisë, ‘Fillon ndërtimi i interkonjeksionit të gazit ndërmjet Serbisë dhe Bullgarisë’, 1 shkurt 2022, <https://www.srbija.gov.rs/vest/en/184444/construction-of-gasinterconnector-between-serbia-bulgaria-begins.php>.

25 Tatiana Mitrova, ‘Ekonomia e Gazit Kaspik’, Qendra për Politikat Globale të Energjisë në Universitetin e Kolumbisë, 26 shtator 2023, <https://www.energypolicy.columbia.edu/qa-the-economics-of-caspian-gas/>.

26 Vladimir Spasić, ‘Srbijagas dhe DEPA planifikojnë të bashkëpunojnë në sektorin e gazit natyror’, Balkan Green Energy News, 8 shtator 2023, <https://balkangreenenergynews.com/srbijagas-depa-plan-to-cooperate-in-natural-gas-sector/>.

27 Pippa Gallop, Igor Vejnović, Davor Pehchevski, ‘Hidrocentrali i Ballkanit Perëndimor: Kush paguan, kush përfiton? Si stimujt e burimeve të rinovueshme kanë ushqyer bumin e vogël të hidrocentraleve dhe çfarë duhet të ndryshojë?’, Rrjeti i EJL Bankwatch, shtator 2019, <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2019/09/who-pays-who-profits.pdf>.

28 Qeveria e Serbisë, ‘Energetski bilans Republike Srbije za 2022. godinu’ [Bilanci energjetik i Republikës së Serbisë për vitin 2022], ‘Gazeta Zyrtare e RS’, nr. 4/2022, 14 janar 2022, https://www.mre.gov.rs/extfile/sr/1144/energetski_bilans_rs_za_2022__0.pdf

29 Barbara Pavlaković, Andrea Okanovic, Bojana Vasić, Jelena Jesic, Polona Šprajc,

Fokusi kohët e fundit është zhvendosur te projektet e energjisë diellore dhe të erës, të cilat po bëhen më me kosto efektive dhe miqësore me mjedisin. Megjithatë, përqindja e këtyre burimeve të energjisë në prodhimin e energjisë elektrike është ende minimale. Zhvendosja nga qymyri tek burimet rinovueshme ngre çështjen e ngarkesës bazë - sasia minimale e energjisë elektrike që duhet të furnizohet në rrjet në çdo kohë të caktuar. Ndërkohë që gazi natyror është një alternativë për sigurimin e kësaj energjie elektrike, veçanërisht gjatë orëve të pikut, hidrocentralet e kthyeshme mund të ofrojnë një alternativë.³⁰

Ndërkohë që interesat ruse janë fokusuar në sigurimin e status quo-së në furnizimin me energji nga lëndët djegëse fosile, veçanërisht nga gazi, kompanitë ruse nuk e kanë penguar zhvillimin e opsioneve “më të gjelbra” të energjisë në Serbi. Përkundrazi, kompanitë e karburanteve fosile po përfshihen edhe në projekte të burimeve të rinovueshme, ndonëse, për momentin, kjo është kryesisht për të mbuluar nevojat e tyre me energji dhe për të treguar se po kontribuojnë në përpjekjet për të trajtuar ndryshimet klimatike. NIS ka investuar në instalimet e termocentraleve diellore në të gjithë rrjetin e pikave të karburantit.³¹ Aktualisht është duke punuar në projektet e hidrogjenit jeshil dhe blu dhe një termocentral me erë në Plandishtë.³²

Pengesat më të mëdha për tranzicionin e energjisë së gjelbër në Serbi janë prodhimi i energjisë elektrike dhe interesat vendase të qymyrit. Roli i qymyrit është vështirë të mbivlerësohet në Serbi, pasi lëndët djegëse fosile të ngurta, kryesisht qymyri i linjtit, përbëjnë dy të tretat e prodhimit parësor të energjisë në vend (Figura 4).³³ Sektori i qymyrit është një nga punëdhënësit më të mëdhenj në Serbi, me 15,262 vende pune të lidhura drejtpërdrejtë me të dhe rreth 37,708 vende pune me lidhje të tërthortë.³⁴ Shteti ka subvencionuar prej vitesh minierat e hapura dhe nëntokësore të qymyrit dhe sektori i qymyrit ka pasur probleme me korrupsionin për një kohë shumë të gjatë.³⁵ Ndonëse këta faktorë ndihmojnë në ruajtjen e status quo-së, varësia tek qymyri për prodhimin e energjisë

‘Hidrocentralet e vogla në vendet e Ballkanit Perëndimor: statusi, polemika dhe një model i propozuar për vendimmarrje’, Energjia, Qëndrueshmëria dhe Shoqëria 12 (9): 1-13, 2022, <https://energysustainsoc.biomedcentral.com/articles/10.1186/s13705-022-00335-7>

³⁰ Dimitar Bechev, ‘Energjia në Ballkanin Perëndimor’, Grupi Këshillimor i Politikave ‘Ballkani në Evropë’ (BiEPAG), 24 maj 2023, <https://biepag.eu/publication/energy-in-the-western-balkans/>.

³¹ Grupi NISH, ‘NISH vazhdon të investojë në energjinë diellore’, 16 maj 2023, www.nis.rs/en/news/nis-nastavija-sa-ulaganjima-u-solarnu-energiju/.

³² Igor Todorović, ‘Kompanitë e naftës në Evropën Juglindore përshpejtojnë investimet në energjinë rinovueshme’, Balkan Green Energy News, 30 maj 2023, <https://balkangreenenergynews.com/oilcompanies-in-southeastern-europe-accelerate-renewable-energy-investments/>


³³ Eurostat, Baza e të dhënave të Energjisë, aksesuar më 5 tetor 2023, Bilanci i Serbisë i energjisë, 2020 Prodhimi Primar Vjetor, Mijëra ton ekuivalent naftë (ktoe), <https://ec.europa.eu/eurostat/web/energy/database>

³⁴ Pablo Ruiz Castello, Hrvoje Medarac, Julian Somers, Giovanni Mandras, ‘Tendencat e fundit në rajonet e qymyrit dhe torfe në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian EUR 30837 EN, 2021, <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/handle/JRC126154>.

³⁵ Damir Miljević, ‘Investimet në të kaluarën: Analiza e subvencioneve të drejtpërdrejta për prodhimin e qymyrit dhe linjtit të energjisë elektrike për vitin 2020 në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, maj 2022, https://www.energy-community.org/dam/jcr:9548dd16-b9ed-4bcc-a562-4ebd5061b082/Coal_Subsidies_Study_070222.pdf; Rrjeti E.J.L. Bankwatch, ‘Termocentrali Kolubara B me linjit, Serbi’, aksesuar më 1 tetor 2023, <https://bankwatch.org/project/kolubara-b-lignite-fired-power-plant-serbia>

elektrike po tërheq, gjithsesi, gjithnjë e më shumë vëmendje, jovetëm për shkak të joefikasitetit dhe keqmenaxhimit të tij, por edhe për shkak të ndikimit të tij në mjedis, kryesisht ndotjes së ajrit.³⁶

Figura 4. Bilanci i energjisë i Serbisë, Prodhimi primar vjetor 2020 (ktoe). Burimi: Eurostat [2020]



Ndryshe nga reagimi negativ kundër qymyrit, reagim që po krijohet ngadalë në Serbi, publiku serb nuk i ka perceptuar furnitorët rusë të karburanteve fosile si ndotës të mëdhenj. Fokusi i Gazprom ka qenë në ruajtjen e monopolit të furnizimit, për të cilin publiku di pak, dhe gazifikimi i Serbisë, i cili i ka sjellë gaz një numri në rritje familjeve dhe që perceptohet se është ekologjikisht i preferueshëm në krahasim me përdorimin e qymyrit dhe drurit për ngrohje në qytetet.³⁷

Po ashtu, NIS është menduar se ka lidhje me përmirësimin e cilësisë së benzinës së prodhuar në Serbi dhe përafrimin e saj me standardet e BE-së, duke kontribuar kështu në një cilësi më të mirë të jetesës në Serbi. Nga ana tjetër, NIS u akuzua për zbrazjen e burimeve vendase të naftës në mënyrë të paqëndrueshme në fillim të viteve 2010. I motivuar nga mundësia e shitjes lirë të naftës kur çmimet globale ishin të larta dhe me një rentë minerare prej 3%, prodhimi i naftës së papërpunuar pothuajse u dyfishua mes viteve 2008 dhe 2013 (Figura 5).³⁸ Në një intervistë, një ish-zyrtar i qeverisë tha se "nxjerrja e naftës bruto nga pusët u bë shumë shpejt, në një mënyrë që nuk lejohet askund në botë". Këto praktika u sollën në vëmendjen e publikut nga një seri artikujsh gazetalesh në vitin 2017, por çështja nuk mori shumë vëmendje dhe është larguar nga debati publik në përgjithësi.³⁹


36 Ajit Niranjana, 'Beogradi: qyteti ku ajri i ndotur shihet si pasojë e rritjes ekonomike', Guardian, 22 shtator 2023, <https://www.theguardian.com/world/2023/sep/22/belgrade-serbia-air-pollution>.

37 Qeveria e Serbisë, "Prezantohen masat për uljen e ndotjes së ajrit", 15 janar 2020, <https://www.srbija.gov.rs/vest/en/149289/measure-to-reduce-air-pollution-presented.php>.

38 Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë, 'Baza e të dhënave: Statistikat vjetore të energjisë, sasitë', aksesuar më 5 tetor 2023, data.stat.gov.rs/.

39 Slađana Vukašinić, 'Nis potrošio svu naftu iz Velebita: Najplodnije nalazište u Srbiji na izdisaju' [NISH harxhoi të gjithë naftën e Velebitit: Fusha më pjellore në Serbi po shfryr], Blic, 25 prill 2017, <https://www.blic.rs/biznis/nis-potrosio-svu-naftu-iz-velebita-najplodnije-nalaziste-usrbiji-na-izdisaju/pnm3es1>.

Figura 5. Prodhimi vjetor i naftës bruto, mijëra tonë.
Burimi: Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë [27.02.2023]



Lidhja e Mjedisit Gjeopolitik

Perceptimet pozitive për Rusinë dhe udhëheqjen e saj politike kanë qenë kryesisht në një linjë me perceptimet pozitive për investimet ruse në sektorin energjetik serb. Autoritetet serbe dhe mediat dominuese pro-qeveritare kanë krijuar vazhdimisht një imazh pozitiv të Ruisë dhe Kinës si aktorë të huaj, ndërsa aktorët perëndimorë janë portretizuar më negativisht (SHBA) ose neutralisht (BE).⁴⁰ Ndofta nuk është për t'u habitur që sondazhi i BiEPAG tregoi se të anketuarit mendonin se investimet ruse kishin ndikim neto pozitiv në mjedis dhe ndërkohë që nga kompanitë perëndimore vinte një ndikim neto negativ (Figura 6).


Por nuk është gjithmonë kështu. Perceptimet për aktorët e huaj nuk përkthehen gjithmonë drejtpërdrejt në atë se si shihen investimet nga këto vende në Serbi dhe duke krahasuar investimet ruse me ato të aktorëve të tjerë mund të nxirret një pamje më komplekse. Publiku i ka perceptuar investimet e fundit kineze në minierat e bakrit në Bor dhe prodhimin e çelikut në Smederevo si varfërim të burimeve dhe dëmtim të mjedisit, duke çuar në mobilizimin e ambientalistëve lokalë dhe kombëtarë kundër projekteve.⁴¹ Sondazhi i BiEPAG tregoi, nga ana tjetër, qëndrime neto negative në lidhje me ndikimin e investimeve kineze në

40 Crta, 'Mediat - Pozitive për Rusinë dhe Kinën, Negative për BE-në dhe SHBA-në', 26 janar 2022, <https://english.istinomer.rs/analyses/media-outlets-positive-on-russia-andchina-negative-on-the-eu-and-the-usa/>

41 Tena Prelec, 'Eko-përbindëshat & Eko-luftëtarët: Investimet e Kinës në industrinë e rëndë të prodhimit të Serbisë, siç shihet përmes një lente mjedisore, Instituti i Studimeve të Sigurisë në Pragë, 26 janar 2021, <https://www.pssi.cz/publications/39-eco-monsters-eco-fighters-china-investments-in-serbia-s-heavy-manufacturing-industry-as-seen-through-an-environmentallens>.

mjedis (Figura 6). Ndonëse perceptimi i përgjithshëm i Ruisë dhe Kinës mbetet pozitiv në Serbi, rritja e dukshmërisë së aktiviteteve kineze i ka ekspozuar ato ndaj një vëmendjeje dhe kontrolli më të madh.

Figura 6. Qëndrimet për ndikimin mjedisor të investitorëve (pa të pavendosurit). Burimi: Sondazhi i BiEPAG, N = 1,019 [2023]




Ky fokus në perceptimin e publikut për varfërimin e burimeve dhe ndikimet negative mjedisore ofron edhe një këndvështrim të dobishëm për të kuptuar qëndrimet e Serbisë ndaj investimeve perëndimore në energji dhe miniera. Në vitin 2021, qeveria serbe pezulloi një investim të njoftuar nga kompania britanike-australiane Rio Tinto në minierat e litiumit pas mobilizimit masiv të ambientalistëve.⁴² Ndonëse në një pjesë të kësaj opozite mund të mbizotërojnë ndjenja anti-perëndimore, kjo ishte shumë më pak vendimtare sesa perceptimi se projekti do të kishte një ndikim negativ në mjedis.

Një drejtues i një grupi parlamentar të opozitës së gjelbër tha në një intervistë në lidhje me kundërshtimin e tyre ndaj Rio Tinto se “pasoja që mbeten në terren janë aq të mëdha sa nuk na intereson se nga vjen investitori”. Një tjetër drejtues i një grupi parlamentar të opozitës së gjelbër kishte një shpjegim më të ekuilibruar për shkallën e mobilizimit kundër Rio Tintos. Ai vuri në dukje se kur bëhet fjalë për investimet kineze, “nuk mund t’i bëhet presion sepse qeveria i mbron”, por kompanitë perëndimore si Rio Tinto nuk përfitojnë nga i njëjti nivel mbrojtjeje. Si e tillë, kur ndjenjat anti-perëndimore ndërveprojnë me shqetësimet mjedisore, “bëhet shumë e lehtë t’i bësh presion dikujt në Perëndim, pasi ata bëhen simbol i të gjitha problemeve tona.”

⁴² Guardian, ‘Planet e Rio Tintos për minierën e litiumit në Serbi u pezulluan pas protestave, 16 dhjetor 2021, <https://www.theguardian.com/environment/2021/dec/16/serbia-blocks-rio-tintos-planto-mine-lithium-after-protests>.

Gjithsesi, ndonëse perceptimet negative të Perëndimit kontribuan në mobilizimin e publikut kundër minierave, ka edhe perceptime që mund të ndihmojnë në mbështetjen e investimeve të burimeve të rinovueshme. Në sondazhin e BiEPAG, dy të tretat e qytetarëve thanë se Serbia duhet të investojë në burimet e brendshme të rinovueshme të energjisë si përgjigje ndaj krizës energjetike, në krahasim me lëndët djegëse fosile ose energjinë bërthamore. Dhe megjithëse publiku serb e identifikoi Rusinë si furnitorin kryesor të lëndëve djegëse fosile, ata identifikuan aktorët perëndimorë, kryesisht BE-në, me rol udhëheqës në zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në Serbi. Këto krahasime të shkurtra tregojnë se ka më shumë për të diskutuar për lidhjen gjeopolitike-mjedisore në Serbi sesa një përkthim i thjeshtë i qëndrimeve politike ndaj aktorëve të huaj në qëndrime ndaj investimeve.

Figura 7. Qëndrimet për ndihmën e jashtme në rritjen e përdorimit të energjisë. Burimi: Sondazhi i BiEPAG, N = 1,019 [2023]



Rruga përpara

Tranzicioni i Serbisë drejt burimeve të rinovueshme është i ndërlidhur me marrëdhëniet e saj të jashtme, që mund të debatohet se është më shumë sesa për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, çështja më e madhe me tranzicionin e gjelbër në Serbi është varësia e brendshme tek qymyri dhe interesat personale në prodhimin e energjisë elektrike me bazë qymyri. Kompanitë në pronësi ruse në Serbi janë të interesuara të nxjerrin fitime nga nafta dhe të ruajnë monopolin e tyre të furnizimit me gaz, gjë që ka penguar që gazi të zgjerojë pjesën e tij në kombinimin e burimeve të energjisë në vend dhe në eliminimin e qymyrit. Kompanitë ruse nuk kanë qenë pengesa aktive drejt tranzicionit të gjelbër. Mbështetja financiare për tranzicionin dhe presioni për të transformuar sektorin energjetik dhe për t'u larguar nga qymyri nuk vjen nga baza, por kryesisht nga jashtë, kryesisht nga BE.

BE duhet të vazhdojë të ofrojë stimuj për dekarbonizimin dhe të pengojë Qeverinë e Serbisë nga investimet e mëtejshme në qymyr. Ky tranzicion do të jetë i kushtueshëm dhe ndihma e drejtpërdrejtë financiare e BE-së mund të jetë një faktor me rëndësi të jashtëzakonshme për procesin. BE mund të mbështesë edhe krijimin në kohë të një skeme të tregtimit të emetimeve në Ballkanin Perëndimor ose një fond special të tranzicionit të drejtë, i njëjtë me Mekanizmin e Tranzicionit të Drejtë të BE-së. Periudha e përshtatjes dhe zbatimit me Mekanizmin e Rregullimit të Kufirit të Karbonit të BE-së (CBAM), i cili pritet të hyjë në fuqi në vitin 2026, lë shumë pak kohë për këto procese transformuese.

Akti balancues i politikës së jashtme të Serbisë, veçanërisht që nga pushtimi rus i Ukrainës në vitin 2022, ka mjegulluar çështjen e tranzicionit energjetik, duke e ngatërruar atë me propagandë të fuqishme në lidhje me marrëdhëniet e vendit me Lindjen dhe Perëndimin. Megjithatë, nga ky studim është evidentuar se gjurmët e prekshme mjedisore të një investitori mund të tejkalojnë edhe perceptimet shumë pozitive të një vendi dhe dallimi për mënyrën se si perceptohen investimet ruse dhe kineze ndihmon në shpjegimin e kësaj lidhjeje gjeopolitike-mjedisore. Aktorët nga Perëndimi duket se do të përballen me një mjedis antagonist në Serbi në vitet në vijim. Për shembull, tarifat CBAM mund të forcojnë propagandën se BE kërkon shumë nga Serbia gjë që mund të bëjë që publiku të kthehet kundër saj në një kontekst të tillë. Megjithatë, kundërshtimi ndaj projekteve të energjisë dhe minierave që degradojnë mjedisin nuk do të thotë se projektet me një gjurmë mjedisore më pak të dukshme do të përballen me të njëjtat sfida.

BE-ja dhe vendet e saj anëtare duhet të mbështesin investimet në projekte energjetike miqësore me mjedisin dhe ndërgjegjësimin dhe angazhimin e publikut në tranzicionin energjetik që mund të ndihmojë

në forcimin e perceptimeve pozitive politike. Në tranzicionin nga qymyri, gazi mund të jetë një lëndë djegëse kalimtare, por për të dekarbonizuar, Serbisë do t'i nevojiten investime në burimet e rinovueshme, veçanërisht në energjinë diellore, të erës dhe hidroenergjisë, dhe potencialisht hidrogjen dhe biomasë. Në vend të qymyrit dhe gazit, hidrocentralet e kthyeshme mund të ofrojnë energji bazë dhe të mbështesin prodhimin e ndërmjetëm nga burimet e rinovueshme. Mbështetja e investimeve të tilla mund të ndihmojë tranzicionin energjetik të Serbisë dhe të shmangë një ndotje të mjedisit. Rritja e ndërgjegjësimit publik për nevojën e vendit për të ndjekur tranzicionin energjetik mund të ndihmojë në krijimin e mbështetjes për këtë tranzicion dhe për BE-në, të cilën qytetarët serbë tashmë e shohin si partner në tranzicionin drejt energjisë së rinovueshme dhe larg qymyrit.

Ashtu si shtetet e tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Serbia përballet me dy rrugë të mundshme kur bëhet fjalë për tranzicionin e energjisë. Një opsion është qasja e "urës së gazit", e cila do të bënte që qymyri të zëvendësohej me gazin natyror si një hap i ndërmjetëm në tranzicionin drejt burimeve të rinovueshme. Opsioni i dytë është që të shkohet direkt te burimet e rinovueshme. Ky studim argumenton se investimet ruse në sektorin e lëndëve djegëse fosile kanë ndjekur trajektore të ndryshme dhe se varësia nga Rusia si furnitor i gazit natyror ka qenë një faktor i rëndësishëm në sekuestrimin aktual të karbonit të Serbisë. Diversifikimi i furnitorëve mund t'i bëjë të mundur Serbisë të përdorë gazin me më shumë fleksibilitet dhe të nisë tranzicionin drejt burimeve të rinovueshme.

BE duhet të vazhdojë t'i mundësojë Serbisë të arrijë sigurinë e gazit natyror dhe diversifikimin e furnizimit, me qëllimin përfundimtar përdorimin e gazit në procesin e eliminimit të përdorimit qymyrit.

Kjo mund të arrihet përmes rritjes së numrit dhe kapacitetit të interkonektorëve që lidhin Serbinë me furnitorë të ndryshëm, një zgjerim të kapacitetit të depozitimit nëntokësor të gazit që do ta bënte Serbinë më të qëndrueshme ndaj goditjeve të jashtme dhe përmes skemave të përbashkëta të blerjes së gazit me BE-në që i bëjnë të mundur Serbisë të paguajë çmime më të ulëta sesa kur e blen si blerës i vetëm. Gazi mund të përdoret si lëndë djegëse për periudhë tranzitore në Serbi dhe mund të shërbejë edhe si urë që vendi të reduktojë varësinë e tij nga qymyri me cilësi të ulët për prodhimin e energjisë elektrike, por qëllimi përfundimtar duhet të jetë rritja e hapësirës manovruese që Serbia të përdorë gazin si zëvendësim për qymyrin gjatë kalimit tek burimet e rinovueshme. Dritarja e mundësive për këtë qasje do të jetë e hapur deri në marrëveshjen e ardhshme serbe të gazit me Rusinë në vitin 2025.

Rreth Nesh

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the Balkans - EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga studiues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Kordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihić, Richard Grieveson, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent kordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

<https://biepag.eu>

Kontakt: MILENA STEFANOVIĆ, Drejtore Programi,

milena.stefanovic@balkanfund.org

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha gjithëpërfshirëse - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritit në BE. Fondacioni mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platforma ku qytetarë

të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

www.balkanfund.org

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive,
aleksandra.tomanic@balkanfund.org

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore

<http://csees.uni-graz.at/>

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER,
Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore,
florian.bieber@uni-graz.at

Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Evropian për Klimën. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim është e autorit(ve). Fondacioni Evropian i Klimës nuk mund të jetë përgjegjës për përdorimet që mund t'i bëhen informacioneve që jepen ose shprehen në këtë studim. Fondi Evropian për Ballkanin 2023.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.

